1	2.426/3	Prishje shtresa betoni	m ³	64.50		
2	An/2.31	Prishje suvatimi	m ²	395.00		
3	An/2.297/a	Prishje tavani kartonxhes	m ²	70.50		
4	2.37/2b	Transport I materiale ndertimi 7 km (mbeturina)	m ³	76.36		
5	An.	Depozitim materiale ndertimi ne landfill (mbeturina)	m ³	76.36		
SHUMA I						
2.Punime ndertimore						
1	2.264	Shtrese lluster cemento 1:2(nen katrama)	m ²	430.0		
2	2.264	Shtrese lluster cemento 1:2(mbi katrama)	m ²	430.0		
3	2.197	Hidroizolim me emulsion bitumi dhe 2 k katrama	m ²	494.0		
4	2.31	Suva brenda mur tulle ~ 4m, me krah, llac perzier M25	m ²	74.2		
5	2.331	Suva e zakonshme fasade mur tulle ~8m	m ²	320.0		
6	2.297/a	Tavan me kartonxhes	m ²	70.5		

7	2.212	Ulluk shkarkimi horizontal me llamarine xingat	ml	160.0		
8	2.209	Ulluk shkarkimi vertikal me llamarine xingat	ml	80.0		
9	2.206	Kasete shkarkimi me llamarine xingat	cope	10.0		
10	An-18	Pusete shkarkimi 50x50, h=100 cm	cope	10.0		
SHUMA II						
3.Punime elektrike						
	480/2	F.V tub plastmasi \varnothing 18~21 mm	ml	150.0		
1	2.487	F.V Kutiderivacioni plastm	cope	8.0		
2	2.485/d	F.V priza shuko "Gevis" universal	cope	6.0		
3	2.485/2	F.V Celes 1 polar 220V 10A "Gevis"	cope	4.0		
4	2.a-127	Ndricues fluoreshent 2x36w, IP40	cope	8.0		
5	2.481/1	F.V percjelles PV-500 \varnothing 1.5 mm ²	ml	100.0		
6	2.481/2	F.V percjelles PV-500 \varnothing 2.5 mm ²	ml	150.0		
SHUMA III						
SHUMA I-III						
Fondi Rezervë						
Shuma						
T V S H 20%						
S H U M A T O T A L E						
						

Nënshkrimi i ofertuesit _____

Vula

Shënim:Çmimet duhet të shprehen në Monedhën ____ (e kërkuar në dokumentat e tenderit)

Shtojca 3.

[*Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik*]
[*Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve*]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

Në emër të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

* * *

Procedura e prokurimit [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-se

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit kontraktor] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërmbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti kontraktor e kerkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës].

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

Shtojca 4.

(Shtojce për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përfaqësuesi i Ofertuesit**Nënshkrimi****Vula**

Shtojca 5.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/ Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE**SPECIFIKIME TEKNIKE****PEROBJEKTIN:“RIKONSTRUKSION I ÇATISE SE GALILEO GALILEIT ”**

Ky dokument të konsiderohet si pjesë përbërëse e Dokumentacionit të Projektit Zbatimit dhe Preventivit Përfundimtar për objektin e mësipërm.

Kontraktorët e Punimeve të Ndërtimit duhet t'u referohen specifikimeve teknike të atyre zërave të punimeve të cilat përfshihen në përshkrimet e Preventivit Përfundimtar si dhe në Përshkrimin e Punimeve.

Këto specifikime teknike duhet të lexohen së bashku me vizatimet teknike dhe detajet e projektit për çdo zë të paraqitur në preventivin e punimeve.

Standartet e përdorura në këto “Specifikime Teknike” dhe që do të aplikohen më tej nuk mbështeten vetëm në vizatimet, por edhe në manualet ligjore dhe libra të tjerë këshillues si:

- Manuali Nr.1 i “Analizat Teknike Prodhimi i Materialeve te Ndertimit”
Tirane – 20.01.2010 (Republika e Shqiperise - Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave).
- Manual Nr.2 i “Analiza Teknike per Punimet e Ndertimit te Ndertesave”, *Tirane –(Republika e Shqiperise-Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave, me vendim Nr.1027, date 15.12.2010).*
- Manualet teknike te cmimeve te ndertimit dhe analizat teknike te tyre" te miratuar me V.K.M.nr. 629, date 15.07.2015 .

Standartet e cilesise se materialeve te perdorura jane , ato te shtetit Shqiptar per materialet prodhim vendi dhe ate te vendeve te Bashkimit European per materialet e importit.

TE PERGJITHSHME

Paragrafet ne kete kapitull jane plotesuese te detajeve dhe i sherbejne kontraktorit per fazen e pergatitjes se ofertes dhe supervizorit gjate fazes se zbatimit. Kontraktori dhe supervizioni duhet te kene parasysh qe:

1. Zevendesimi i materialeve te specifikuara ne Dokumentin e Kontrates do te behet vetem me aprovimin e Supervizorit ne se materiali i propozuar per tu zevendesuar eshte i njejte ose me i mire se materialet e specifikuara, ose ne se materialet e specifikuara nuk mund te sillen ne sheshin e ndertimit ne kohe per te perfunduar punimet e Kontrates, per shkak te kushteve jashte kontrollit te Kontraktorit dhe vendndodhjes se objektit. Qe kjo te merret ne konsiderate, kerkesa per zevendesim do te shoqerohet me nje dokument- deshmi te cilesise, ne formen e kuotimit te certifikuar dhe te dates se garancise te dorezimit nga furnizuesit e te dy materialeve, si te materialit te specifikuar ashtu edhe te atij qe propozohet te ndryshohet.

2. Kontraktori do te verifikoje te gjitha dimensionet, sasite dhe detajet te treguar ne vizatimet, grafiket,ose te dhena te tjera dhe Punedhensi nuk do te mbaje pergjegjesi per ndonje mangesi ose mosperputhje te gjetur ne to. Moszbulimi ose korrigjimi i gabimeve ose mosperputhjeve nuk do ta lehtesoje Kontraktorin nga pergjegjesia per pune te pakenaqeshme. Kontraktori do te marre persiper te gjithe pergjegjesine ne berjen e llogaritjeve te madhesive , llojeve dhe sasive te materjaleve dhe pajisjeve te perfshira ne punen qe duhet bere sipas Kontrates. Ai nuk do te lejohet te kete avantazhe nga ndonje gabim ose mosperputhje, ndersa nje udhezim i plote do te jepet nga Punedhensi ne se gabime te tilla ose mosperputhje do te zbulohen.

3. Kontraktorit nuk do te behet asnje pagese mbi cmimet njesi te kuotuar per kostot e mobilizimit d.m.th. per sigurimin e transportit, energjine, veglat dhe pajisjet,ose per furnizimin e godines dhe mirembajtjen e impjanteve te ndertimit, rrugeve te hyrjes, te komoditeteve sanitare, heqje e mbeturinave, punen per fumizimin me uje, mbrojtjen kundra zjarrit, bangot e punes, rojet, per kujdesin mjeksor, ose per ndonje sherbim tjetër, lehtesi, gjera, te nevojshme qe kerkohen per zbatimin e punimeve ne perputhje me ate qe eshte parashikuar ne Kontrate. Kontraktori do te furnizojë dhe mirembaje me shpenzimet e tij, rrethimin dhe materiale te tjera te tilla dhe te jape asistencë nepermjet nje stafi te kualifikuar sic mund te kerkohet nga Punedhensi per kontrollin e modinave dhe piketave.

4. Kontraktori duhet te beje forografi me ngjyra sips udhezimeve te Supervizorit ne vendet e punes per te demonstruar kushtet e sheshit perpara fillimit , progresin gjate punes se ndertimit dhe mbas perfundimit te punimeve. Nuk do te behen pagesa per fotografimin e kantierit te punimeve pasi keto shpenzime jane parashikuar te mbulohen nen koston administartive te Kontraktorit.

5. Kontraktori do te mare masa paraprake per mbrojtjen e punetoreve te punesuar dhe te jetes publike si edhe te pasurive ne veper dhe rreth objektit te ndertimit. Masat e sigurimit paraprak te ligjeve te aplikushme, kodeve te ndertesave dhe te ndertimit do te respektohen edhe per makinerite, pajisjet dhe cdo rrezik do te kqyren ose eliminohen ne perputhje me masat paraprake te sigurimit.

6. Kontraktori transportin e cdo materiali nga kavot, nyjet apo magazinat e ndryshme, do ta beje me makina te pershtateshme te cilat kur ngarkohen nuk shkaktojne derdhje dhe e gjithe ngarkesa te jete e siguruar. Te gjitha materialet ,duhet te stivohen ose te magazinohen ne menyre te pershtateshme per ti mbrojtur nga rreshqitjet, demtimet, thyerjet, vjedhjet dhe ne dispozicion per tu kontrolluar nga Supervizori ne cdo kohe.

7. Kontraktori duhet te pergatise vizatimet per te gjitha punimet "sic jane faktikisht zbatuar" ne terren. Vizatimet do te behen ne nje standart te ngjashem me ate te vizatimeve te Kontrates.

8. Gjate zbatimit te punimeve ne kantier, Kontraktori do te ruaje te gjithe informacionin e nevojshem per pergatitjen e "Vizatimit sic eshte zbatuar"per punimet kryesore dhe ato te maskuara. Do te shenoje ne menyre te qarte vizatimet dhe te gjitha dokumentet e tjera, te cilat mbulojne punen

e vazhdueshme te perfunduar. Keto vizatime do te azhurnohen ne menyre te vazhdueshme dhe do ti dorezohen Supervisorit per aprovim, se bashku me kopjen perfundimtare. Materiali mujor do te dorezohet ne 3 kopje leter.

9. Para se te filloj puna ne kantier te stakohet energjia elektrik.e ne objekt dhe rrjeti i ujesjellesit per arsye te shmangies te ndonje incidenti te mundeshem nga pakujdesia ne kantier.

Metoda e prishjes

Puna per prishje do te filloje vetem pasi te jene stakuar energjia elektrike dhe rrjete te tjera te instalimeve ekzistuese te objektit.

Kur prishen elementet, duhen marre masa per te mos rrezikuar elementet e tjere konstruktive mbajtes, si dhe mos demtohen elementet e tjere.

Ne pergjithesi, puna e shkaterrimit duhet te filloje duke hequr sa me shume ngarkesa te panevojshme, pa nderhyre ne elementet haze struktural. Pune te kujdeshme do te behen per te hequr ngarkesat kryesore nen kushtet me te veshtira.

Siguria ne pune

Kontraktori duhet te sigurohet se vendi dhe pajisjet jane :

a)Te nje tipi dhe standarti te pershtatshem duke iu referuar vendit dhe llojit te punes qe do te kryhet

b)Te siguruar nga nje teknik kompetent dhe me ekperience

c)Te ruajtura ne kushte te mira pune gjate perdorimit

Gjate punes prishese te gjithe punetoret duhet te vishen me veshje te pershtatshme mbrojtese ose mjete mbrojtese si: helmata, syze, mbrojtese, mbrojtese veshesh, dhe bombola frymemarrije.

PUNIME PRISHJE

Prishje e pjesshme te shtresave te hidroizolimit te soletes ku perfshihen : Prishje hidroizolimi pjeserisht, perfshire tere masat qe duhen marre per aplikimin e te gjithe akteve perkatese te sigurise se mbrojtjes se punetoreve, pasurise dhe jetes se komunitetit dhe kalimtareve.

Ne punimet e prishjes perfshihen shpenzimet e puntorise te nevojeshme per realizimin e plote te cdo procesi te percaktuar ne preventiv.

Transporti perfshin shpenzimet per ngarkimin e materialeve qe rezultojne nga prishja, perfshire transportin me automjet dhe shkarkimin ne vendin e caktuar deri ne 7 km.

PUNIME TAVANI

Tek ky proces pune do te realizohet patinimi i tavanit ne te gjitha zonat ne te cilat lageshtira ka depertuar dhe ka sjelle nevojën e patinimeve pjesore. Ne cmim perfshihen shpenzimet e punetore per realizimin e 1 m² tavan, blerjen e materialeve dhe aksesoreve te nevojshem, transportin e tyre dhe vendosjen ne objekt.

PUNIME HIDROIZOLIMI

Ky ze punimi pershin faktin qe ne objekt do te realizohet hidroizolimi i pjesshem godines. Ne cmim perfshihen te gjitha shpenzimet e punetore per realizimin e hidroizolimit te taraces me 2 duar k.katrama, blerjen e materialeve e aksesoreve te nevojshme, transportin dhe vendosjen e tyre ne objekt. Vendosje e ulluqeve ne pusetat e shiut. Vendosja e mberthyesve per antenat dhe çdo gje tjeter te ngjashme. Shtrese lluster çimento me trashesi min 3 cm, me dozim 1:2 e niveluar dhe pastruar per vendosjen e membranës hidro-izoluese.

Çdo gje tjeter te nevojshme per perfundimin dhe realizimin e taraces ne menyre perfekte.

PUNIME SHITESASH

Shtrese lluster çimento 1:2, t=20mm, hedhjen dhe nivelimin e shtreses se llustres se çimentos 1:2, t=20 mm me dozimin perkates per m² , me trashesi sipas percaktimeve ne projekt, e hedhur ne objekt duke perfshire cdo detyrim tjeter per perfundimin e punes me cilesi. Te gjitha duhet te jene ne perputhje me specifikimet, standartet dhe kerkesat e specifikuara ne kete material.

Garancine per pune te sigurte per punonjesit pjesemarres ne proces te kalimtareve dhe te komunitetit. Suvaja hidhet me dore ose me makineri. Ne rast se perdoret nje makineri per hedhje suvaje, kontrollohet fluiditeti i suvase. Aplikohen suvate e gipsit, çimentos dhe stukot ne tre shtresa (dy baze dhe nje perfundimtare). Suvaja nuk vazhdon pergjate nyjeve, bashkimeve dhe lidhjeve te mureve me muret ndares dhe tavanin. Puna perfundimtare duhet te jete e drejte, vertikale, e sakte, me nje tolerance 3mm ne 2500mm, pa vlezime, krisje, plasarijete, vrime, çngjyrosje, shtemberime ose pasaktesira te tjera. Formohet me kujdes suvaja perreth kendeve dhe kontureve. Merren masa paraprake per te parandaluar renien dhe pikimin e materialit. Nuk duhet te kete shenja lidhjesh dhe bashkimesh ne siperfaqen perfundimtare te suvase. Behen instalimet e lidhjeve dhe bashkimeve para se te filloje puna suvatuesve. Lidhjet vertikale duhet te jene te vazhdueshme dhe shenohen lidhjet horizontale kundra atyre vertikale.

KANALET DHE AKSESORET ELEKTRIK

Instalime elektrike do te behen nen suva dhe te futura ne tuba PVC fleksibel. Aksesoret e instalimeve jane tubat fleksibel PVC te dimensioneve te ndryshme ne varesi te dimensionit dhe te numrit te telave qe do te futen ne te.

Per kryerjen e instalimeve elektrike te futura nen suva duhet te ndiqet rradha e punes si me poshte:

Hapja e kanaleve ne mur me dimension te tille qe te vendoset lirshem tubi fleksibel dhe me thellesi te tille qe te mos dale mbi nivelin e suvase perfundimtare.

Vendosen tubat fleksibel dhe kutite prej PVC te cilet provizorisht fiksohen me allçi (me vone mbyllen kanalet me llac suvatimi).

Pasi eshte kryer suvatimi, futen telat ose kabllot, me ane te udhezuesit te tyre, te cilat duhet te hyjne lirshem dhe te lihet ne te dy krahet nje sasi e mjaftueshme per kryerjen e lidhjeve dhe montimeve.

Kutite shperndarese zgjidhen sipas rastit dhe nevojës. Ato jane ne forme katrore ose drejtkendeshe dhe kapak mbylles. E rendesishme eshte qe lidhja e telave/kabllove brenda ne kutite shperndarese te realizohet me ane te morsetave sipas permasave bashkuese ose fundore. Vendodhja e çelesave te ndricimit tregohet sipas projektit dhe skicave te bera nga inxhinieri elektrik projektues. Ne pergjithesi celesat e ndricimit duhet te jene te pershtatshme per montim te rrafshet (nen suvatim).

Çelesat duhet te jene te tipit te nderprerjes se ndadalte "quick make slowbreak" te projektuara per kontrollin e rrjetit AC. Duhet te kene nje shkalle minimale prej 10 amper. Çelesat duhen te montuara ne nje rrjet elektrik per te siguruar, shtrirjen e duhur, kur kutite e kablllove metalike te perputhen rrafsh me suvatimin e murit.

Shtojca 6

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/ Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti/ kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

GRAFIKUT I ZBATIMIT TË PUNIMEVE

Afatet e realizimit të punimeve:

<i>1</i>	<i>2</i>	<i>3. Afati i realizimit</i>				
Nr	Përshkrimi i Punëve	Java 1/	Java 2	Java 3	Java 4	
1.						
2.						
3.						
4						

Shënim. Autoriteti/ kontraktor mund të shtojë rreshta në varësi të zërave të punimeve dhe kollona në varësi të afatit të parashikuar për realizimin e tyre.

Shtojca 7

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë veprë penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendim i gjykatës i formës së prerë për çdo veprë penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale;
- dh) nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojces 8.

Në rast të bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një Bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8,*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:

Nuk është e aplikueshme

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2018, 2019, 2020), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më pak se 40% e vlerës së fondit limit.

2.2.2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilanci vjetore, për vitet financiare, 2018, 2019, 2020, të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve nga neni 41, pika "c", e ligjit nr.10091 date 5.3.2009 "*Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit te ekspertit kontabel te regjistruar dhe te kontabilistit te miratuar*" i ndryshuar, atëherë bilanci duhet të shoqerohet me akt-ekspertizën e kryer nga eksperti kontabel. Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më pak se 30% të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik ose fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,
ose
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë, fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Për të vërtetuar përvojën e suksesshme në ekzekutimin e një kontrate të ngjashme, Operatori Ekonomik duhet të paraqesë dokumentat e mëposhtëm :

Për të vërtetuar përvojën e suksesshme në ekzekutimin e një kontrate të ngjashme, Operatori Ekonomik duhet të paraqesë dokumentat e mëposhtëm :

Për kontrata të realizuara me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- Deklaratën sipas shtojcës perkatese, shoqëruar me:
- Kontratë
- Situacionin përfundimtar;
- Aktin e kolaudimit;
- Çertifikaten e marrjes ne dorezim.
- **Fatura tatimore e situacionit përfundimtar.**

Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- Deklaratën sipas shtojcës perkatese, shoqëruar me:
- Kontrate;
- Situacionin përfundimtar;
- Akt kolaudimi objekti;
- Çertifikaten e marrjes ne dorezim te objektit;
- **Fatura tatimore e situacionit përfundimtar.**

Pika 1/a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

**Nuk do te merret në konsideratë asnje punim i pavertetur.*

2.3.2. Operatorët ekonomik oferutes duhet të paraqesin licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë bazuar në formatin e miratuar me Vendim të Keshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, e cila përfshin kategoritë e mëposhtme :

- a. Liçenca e shoqërisë e vlefshme për kategoritë e mëposhtme:
 - NP – 3 A Rikonstruksion dhe mirëmbajtje godina civile dhe industriale
- b. Për punimet speciale të ndërtimit Liçenca e shoqërisë e vlefshme për kategoritë e mëposhtme:
 - NS – 4 A Punime të rifiniturës dhe të lidhura me to
 - NS – 14 A Impiante të brëndshme elektrike, telefoni, radiotelefoni, TV, etj.

Operatorët e huaj duhet të bëjnë ekuivalentimin e licencave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastrukturas dhe Energjisë, (ose Ministrisë kompetente të kohës) Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, e miratuar me VKM- në Nr.42, datë 16.01.2008).

Mosparaqitja në këtë formë është kusht skualifikues.

2.3.3. Duke vlerësuar llojin, volumet e punimeve dhe afatin e zbatimit të punimeve, të përcaktuara nga projektuesit për këtë objekt, O.E. pjesëmarrës, për kryerjen e këtij Investimi duhet të ketë një punësim mesatar jo më të vogël se **11 (njembëdhjetë)** punonjës , për periudhën **3 (tre) muajt e fundit nga data e hapjes së prokurimit**, të vertetuar me:

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve për periudhën tre mujore duke filluar nga data e publikimit të njoftimit të kontratës, sipas formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr.8.

Ndërsa operatori ekonomik fitues, para lidhjes së kontratës, duhet të dorëzojë dokumentacionin si më poshtë :

- Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet Shoqërore ose Administrata Tatimore sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj, për periudhën **si më sipër**.
- Listë pagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën **si më sipër**.

2.3.4. O.E. pjesëmarrës duhet të kenë në stafin e tyre të punësuar me kohë të plotë dhe të jenë aktualisht si Drejtues Teknik në Liçencën e shoqërisë si dhe në Listë pagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën **3 (tre) muajt e fundit nga data e hapjes së prokurimit**, të vërtetuar me:

1. Kontratë pune të vlefshme
2. Diplomë
 - 1 (nje) Inxhinier Ndërtimi

*Drejtuesit Teknik nuk duhet të jenë të dypunësuar. Kjo në zbatim të V.K.M. Nr. 42, datë 16.01.2008. Si rrjedhojë O.E. duhet të deklarojë se Drejtuesit Teknik nuk janë të dypunësuar apo të angazhuar në ndonjë veprimtari tjetër jashtë O.E. pjesëmarrës. **A.K. rezervon të drejtën e verifikimit të Deklaratës.***

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin sipas formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr.8.

Ndërsa operatori ekonomik fitues, para lidhjes së kontratës, duhet të dorëzojë dokumentacionin e sipërkërkuar.

2.3.5. O.E. pjesëmarrës duhet të kenë në stafin e tyre të punësuar, me kohë të plotë / jo të plotë:

- 1 (një) Ekspert M.N.Z.i çertifikuar, vertetuar me:
 1. Kontratë pune (të vlefshme për të paktën periudhën e zbatimit të Kontratës)

2. Leje e Ekspertit M.N.Z., të vlefshme.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin sipas formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr.8.

Ndërsa operatori ekonomik fitues, para lidhjes së kontratës, duhet të dorëzojë dokumentacionin e sipërkërkuar.

2.3.6. Duke vlerësuar llojin, volumet e punimeve dhe afatin e zbatimit të punimeve, të përcaktuara nga projektuesit për këtë objekt, krahas stafit të mësipërm O.E. pjesëmarrës për kryerjen e këtij Investimi, duhet të ketë punonjës specialistë me kohë të plotë, të paisur me dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik nga I.SH.T.I. ose nga institucione ekuivalente me të, ku nga këta të jenë të paktën:

- 1 (një) Elektriçist
- 2 (dy) Hidroizolues
- 1 (një) Karpentiere
- 2 (dy) Suvatues
- 2 (dy) Specialist gipsi
- 1 (nje) Specialist për punime në lartësi

të vërtetuar me:

1. Dëshmi përkatëse të kualifikimit të sigurimit teknik
2. Kontratë pune të vlefshme

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin sipas formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr.8.

Ndërsa operatori ekonomik fitues, para lidhjes së kontratës, duhet të dorëzojë dokumentacionin e sipërkërkuar.

2.3.7. Krahas stafit të mësipërm O.E. pjesëmarrës për kryerjen e këtij Investimi, duhet të ketë të paktën **1 (nje) punonjës** të pajisur me Çertifikatë për Mbrojtjen e Shëndetit dhe Sigurisë në Punë, lëshuar nga Institucionet përkatëse”, në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10327 date 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe V.K.M nr. 312, date 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier", të vërtetuar me:

1. Çertifikatë për Mbrojtjen e Shëndetit dhe Sigurisë në Punë, lëshuar nga Institucionet përkatëse
2. Kontratë pune të vlefshme
3. Diplomë
4. Librezë pune

5. Të jenë në Listë pagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën **3 (tre) muajt e fundit nga data e hapjes së prokurimit**

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin sipas formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr.8.

Ndërsa operatori ekonomik fitues, para lidhjes së kontratës, duhet të dorëzojë dokumentacionin e sipërkërkuar.

2.3.8. O.E. duhet të jetë i paisur me Çertifikatë të Cilësisë së Punimeve **ISO 9001 – 2015** ose ekuivalente, të vlefshme, e akredituar nga D.P.A. ose nga Organizma Ndërkombëtar Akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Në rastet e bashkimit të O.E., seicili nga anëtarët e bashkimit të grupit duhet të plotësojë kërkesën e mësipërme, në përputhje me zërat e punimeve që ka marrë përsipër të realizojë sipas Akt Marrëveshjes së Bashkëpunimit.

2.3.9. O.E. duhet të jetë i paisur me Çertifikatë **ISO 18001 – 2007 ose ekuivalente**, të vlefshme, e akredituar nga D.P.A. ose nga Organizma Ndërkombëtar Akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Në rastet e bashkimit të O.E., seicili nga anëtarët e bashkimit të grupit duhet të plotësojë kërkesën e mësipërme, në përputhje me zërat e punimeve që ka marrë përsipër të realizojë sipas Akt Marrëveshjes së Bashkëpunimit.

2.3.10. O.E. duhet të jetë i paisur me Çertifikatë **ISO 14001 – 2015 ose ekuivalente**, të vlefshme, e akredituar nga D.P.A. ose nga Organizma Ndërkombëtar Akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Në rastet e bashkimit të O.E., seicili nga anëtarët e bashkimit të grupit duhet të plotësojë kërkesën e mësipërme, në përputhje me zërat e punimeve që ka marrë përsipër të realizojë sipas Akt Marrëveshjes së Bashkëpunimit.

2.3.11. Duke vlerësuar llojin, volumet e punimeve dhe afatin e zbatimit të punimeve, të përcaktuara nga projektuesit për këtë objekt, O.E. pjesëmarrës për kryerjen e këtij Investimi, duhet të deklarojnë se disponojnë makineritë dhe mjetet e mëposhtme:

Nr	Makineritë / Mjetet	Njësi	Sasi	Gjendja Juridike
1	Kamionçinë, kapaciteti mbajtës 3.5 – 5 ton	copë	1	Pronësi ose me qera
2	Autobot uji, kapaciteti 2000 litra	copë	1	Pronësi ose me qera
3	Matrapik	copë	1	Pronësi ose me qera
4	Kompresor	copë	1	Pronësi ose me qera
5	Gjenerator 0.4 kV, me fuqi jo më pak se 10 kË	copë	1	Pronësi ose me qera
6	Depozitë uji, kapaciteti 5000 litra	copë	1	Pronësi ose me qera
7	Skela metalike	m2	800	Pronësi ose me qera
8	Panel elektrik i paisur me matës të energjisë elektrike (për matjen e konsumit të energjisë elektrike te O.E.)	copë	1	Pronësi ose me qera

Është e mjaftueshme paraqitja e deklaratës, sipas shtojcës nr.8 dhe dokumentacioni si më poshtë:

- A.** Për mjetet në Pronësi që shënohen në Rregjistra Publikë duhet të paraqiten:
1. Çertifikatë mbi Pronësinë e mjetit rrugor, lëshuar nga D.P.SH.T.RR.
 2. Leje qarkullimi, të vlefshme, lëshuar nga D.P.SH.T.RR.
 3. Çertifikata e kontrollit teknik të mjeteve rrugore, të vlefshme, lëshuar nga D.P.SH.T.RR.
 4. Police për sigurimin e detyrueshem ndaj palëve të treta (T.P.L.), të vlefshme, lëshuar nga njëra prej Kompanive të Sigurimit që operojnë në tregun shqiptar.
 5. Çertifikatë për transport mallrash për të tretë dhe me qera, të vlefshme, lëshuar nga D.P.SH.T.RR.

B. Për mjetet me Qera që shënohen në Rregjistra Publikë duhet të paraqiten:

1. Çertifikatë mbi Pronësinë e mjetit rrugor, lëshuar nga D.P.SH.T.RR.
2. Leje qarkullimi, të vlefshme, lëshuar nga D.P.SH.T.RR.
3. Çertifikata e kontrollit teknik të mjeteve rrugore, të vlefshme, lëshuar nga D.P.SH.T.RR.
4. Police për sigurimin e detyrueshem ndaj palëve të treta (T.P.L.), të vlefshme, lëshuar nga njëra prej Kompanive të Sigurimit që operojnë në tregun shqiptar.
5. Çertifikatë për transport mallrash për të tretë dhe me qera, të vlefshme, lëshuar nga D.P.SH.T.RR.
6. Kontrata përkatëse e qerasë, e vlefshme për të paktën periudhën e zbatimit të Kontratës.

C. Për mjetet në Pronësi që nuk shënohen në Rregjistra Publikë duhet të paraqiten:

1. Fatura tatimore të blerjes, akt çdoganimi për mjetet e importuara.

D. Për mjetet me qera që nuk shënohen në Rregjistra Publikë duhet të paraqiten:

1. Fatura tatimore të blerjes, akt çdoganimi për mjetet e importuara.
2. Kontrata përkatëse e qerasë, e vlefshme për të paktën periudhën e zbatimit të Kontratës.

E. O.E. duhet të paraqesë foto të mjeteve ku të jenë të dallueshme qartësisht të gjitha elementet e mjetit.

F. O.E. duhet të deklarojë që mjetet e mësipërme nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera, si dhe vendndodhjen e tyre (adresën e saktë).

G. A.K. rezervon të drejtën e verifikimit dhe të kontrollit në çdo kohë, deri në përfundimin e kontratës, për makineritë / mjetet të deklaruara nga O.E.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë mjetet dhe pajisjet që disponojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

2.3.12 Grafiku i Punimeve

2.3.13 Analizat e cmimeve

Shënim:

- **Per te gjitha dokumentat e siperkeruara, ku eshte kerkuar qe per permbushjen e tyre operatori ekonomik duhet te nenshkruaj formularin e vetdeklarimit, AK sqaron se operatori ekonomik fitues, para lidhjes se kontrates, duhet te dorezoje dokumentacionin ashtu si eshte kerkuar.**

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Shtojca 8.

(Shtojcë për tu paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT

I. Unë i nënshkruari _____ në cilësinë e _____ të operatorit ekonomik _____

deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

PJESA I: A. INFORMACION NË LIDHJE ME OPERATORIN EKONOMIK

Identifikimi	Përgjigja
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE)	-----
Numri NIPT/et:	-----
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	-----

Përfaqësuesi (emri):	-----
Telefoni:	-----
E-mail:	----- ---

B: DEKLARATË

Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- Informacione për nënkontraktorin**

Emri i nënkontraktorit të propozuar	NIPT – i	Përqindja e nënkontraktimit	Punët/ pajisjet e lidhura me to për t'u nënkontraktuar

- Informacion mbi subjektet, mbi kapacitetin e, të cilave do të mbështetet operatori ekonomik**

Emri (at) e subjekteve	NIPT-i	Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik	Specifiko konkretisht kapacitetin/et

Deklaroj se, për subjektin / subjektet në kapacitetin/et, e të cilit/ëve do të mbështetem, nuk ka arsye për skualifikimin ose përjashtimin e tij / tyre nga procedura, në përputhje me dispozitat e nenit 76 të LPP-së, dhe konfirmoj me dokumente provuese që do të ketë burimet e kërkuara siç janë deklaruar.

Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

Deklarata	Referencat (kur janë të zbatueshme)
Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv.	Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]
Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së.	Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]
Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë: <hr/> <hr/> etj. nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj.	Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]
Operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për	Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni:

vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.	Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]
Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).	Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]
Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së	Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]
Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.	Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]
Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi, përfshirë legjislacionin mjedisor, social dhe të punës.	Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]
Operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së. Operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së	Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]

Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.	
--	--

B: DEKLARATA Për Dorëzimin e Ofertave të Pavarura

--

Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e operatorit ekonomik, bëj këtë deklaratë në përputhje me nenin 1 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", dhe në zbatim të Ligjit Nr. 9121/2003 "Për Mbrojtjen e Konkurrencës", dhe garantoj që deklaratat e mëposhtme janë të vërteta dhe të plota në çdo aspekt:	_____
1. Kam lexuar dhe kuptuar përmbajtjen e kësaj deklaratë;	Po []
2. Kuptoj që oferta e paraqitur do të skualifikohet dhe / ose përjashtohet nga pjesëmarrja në prokurimin publik nëse kjo Deklaratë konstatohet se nuk është e plotë dhe / ose e pasaktë në të gjitha aspektet;	Po []
3. Jam i autorizuar nga Ofertuesi për të nënshkruar këtë Deklaratë dhe për të paraqitur një Ofertë në emër të Ofertuesit;	Po []
4. Çdo person, nënshkrimi i të cilit paraqitet në dokumentacionin e ofertës është i autorizuar nga ofertuesi për të përgatitur dhe për të nënshkruar ofertën në emër të ofertuesit;	Po []
5. Për efekt të kësaj deklaratë dhe ofertës së paraqitur, unë e kuptoj se fjala "konkurrent" nënkupton çdo operator tjetër ekonomik, përveç Ofertuesit, pavarësisht nëse paraqitet si një bashkim i operatorëve ekonomikë ose jo, që: a) paraqet një ofertë në përgjigje të Njoftimit të Kontratës të bërë nga Autoriteti Kontraktor; b) është ofertues i mundshëm i cili, bazuar në kualifikimet, aftësitë ose përvojat e tij, mund të paraqesë një Ofertë në përgjigje të Njoftimit të Kontratës .	Po []
6. Ofertuesi deklaron se e ka përgatitur ofertën e tij në mënyrë të pavarur, pa u konsultuar, komunikuar dhe pa pasur ndonjë marrëveshje ose dakord me ndonjë konkurrent tjetër;	Po [] Jo []
7. Ofertuesi deklaron se është konsultuar, ka komunikuar, ka lidhur marrëveshje me një ose më shumë konkurrentë në lidhje me këtë procedurë prokurimi. Ofertuesi deklaron se në dokumentet e bashkangjitura, detajet e kësaj oferte përfshijnë emrat e konkurrentëve, natyrën dhe arsyet e konsultimit, komunikimit, marrëveshjes ose angazhimit (në rast të një bashkimi të operatorëve ekonomikë ose nën-kontraktimit).	Po [] Jo []
8. Në veçanti, pa cenuar pikat 6 dhe 7 më lart, nuk ka pasur asnjë konsultim, komunikim, kontratë ose	Po [] Jo []

